

TASA-ARVOISENA SUOMESSA
Tietoa maahanmuuttajanaiselle ja -miehelle
TË BARABARTË NË FINLANDË
Informata për emigrantë

1. HYRJE

Pozita e gruas dhe burrit në shoqëri përcaktohet në mënyra të ndryshme në kultura të ndryshme. Edhe pikëpamjet për familjen janë të ndryshme në vende të ndryshme të botës. Në këtë broshurë flitet për pozitën e gruas dhe të burrit në Finlandë dhe se si e kuptojnë finlandezët barazinë.

Broshura është për gra dhe burra që shpërngulen në Finlandë, si dhe për familjet e tyre. Në të janë mbledhur informata të rëndomta mbi jetën familjare, edukimin e fëmijëve, shkollimin dhe jetën e punës. Qëllimi i broshurës është të ndihmojë në kuptimin e mënyrës së veprimit të finlandeze.

Të gjithë njerëzit në Finlandë kanë të drejtë të trajtohen në mënyrë të barabartë. Asnjë nuk mund të diskriminohet në bazë të gjinisë, origjinës etnike dhe fesë. Diskriminimi është i ndaluar sipas ligjit finlandez dhe sipas marrëveshjeve të shumta ndërkombëtare që Finlanda ka nënshkruar. Të njëjtat të drejta, detyra dhe mundësi i përkasin si grave ashtu edhe burrave. Parimi i trajtimit në mënyrë të barabartë i përket si emigrantëve ashtu edhe nënshtetasve finlandezë.

Nga zyrat komunale ku jetoni mund të merrni informata të mëtejshme mbi çështjet e cekura në broshurë. Në se nuk ju mjaftojnë njohuritë gjuhësore kur takoheni me autoritetet zyrtare mund të pyesni prej tyre mundësinë për të marrë përkthyes. Kur keni punë me autoritetet zyrtare nuk është mirë të përdorni fëmijën ose bashkëshortin si përkthyes. Në se është e mundshme ja vlen të përdorni gjithmonë përkthyes profesionist.

Pyetni prej autoriteteve zyrtare mundësinë për të përdorur përkthyes, ose për shërbime falas të përkthimit.

Këshilla të veçanta për emigrantë

Në shumë komuna ka **pika informacioni të veçanta për emigrantë** dhe punëtorë të specializuar për emigrantë, të cilët ndihmojnë në probleme të përditshme ose ju tregojnë se nga mund të merrni ndihmë.

2. JETA FAMILJARE

Në Finlandë familjet janë zakonisht të vogla, sepse me prindërit dhe fëmijët rrallëherë jetojnë të afërm të tjerë në të njëjtën shtëpi. Familja përbëhet, për shembull, nga shoku/shoqja, bashkëshortët me fëmijë, ose një prej prindërve bashkë me fëmijët. Në shumë familje ka përveç bashkëshortëve dhe fëmijëve të tyre të përbashkët dhe fëmijë të martesave të kaluara të njërës prej bashkëshortëve.

Me bashkëshortë kuptohet çifte që jetojnë në martesë ose në bashkëjetesë. Edhe partnerë të të njëjtes gjini kanë mundësi të regjistrohen në Finlandë si çifte. Në Finlandë prindërit nuk vendosin se me cilin mund të martohet fëmija i tyre. Si gratë ashtu dhe burrat mund të zgjedhin lirisht partnerin e tyre të jetës.

MARTESA

Në Finlandë martesa bëhet ose me lidhje kurore në kishë ose me regjistrim civil në zyrën e gjendjes civile. Para martesës sqarohet nëse ka pengesa për të apo jo. Sipas ligjit finlandez personi që është ende në martesë nuk mund të martohet. Edhe personat nën 18-vjeç ose ata që kanë lidhje të ngushta farefisnore nuk mund të martohen. Pengesat e martesës shqyrtohen sipas ligjit finlandez në rast se njëri prej bashkëshortëve është nënshkruar finlandez, ose jeton në Finlandë.

Para se të martohen, çifti duhet të paraqesë lutjen për shqyrtimin e pengesave të martesës. Shqyrtimi bëhet ose nga **zyra e gjendjes civile**, ose nga **famullia**, në të cilën njëri ose të dy personat bëjnë pjesë.

Mbiemri

Para lidhjes së kurorës bashkëshortët bien dakort për mbiemrin e ardhshëm. Sipas ligjit finlandez ata mund të mbajnë mbiemrat e tyre, respektivisht, ose të marrin mbiemrin e njërit prej bashkëshortëve si mbiemër të përbashkët.

Mbiemri i zgjedhur influencon në mbiemrin e fëmijës

ALTERNATIVA 1

Bashkëshortët marrin një mbiemër të përbashkët, të burrit ose të gruas. Bashkëshorti mbiemri i të cilit ndryshon mund të përdorë një kombinacion ku mbiemri i ri vendoset pas të vjetrit.

Në këtë rast fëmijët marrin mbiemrin e prindërve.

ALTERNATIVA 2

Secili nga bashkëshortët mban mbiemrin e tyre.

Atëhere prindërit vendosin se mbiemrin e kujt do marrë fëmija, të nënës apo babait. Të gjithë fëmijët duhet të kenë të njëjtin mbiemër.

Të drejtat dhe detyrat në martesë

Sipas ligjit finlandez të drejtat dhe detyrat e bashkëshortëve janë të njëjta. Detyrat lidhur me mirëmbajtjen e familjes, si puna dhe detyrat e shtëpisë ndahen zakonisht në mënyrë të barabartë.

Të dy bashkëshortët mund të marrin pjesë në mbajtjen e familjes duke shkuar në punë. Nëse njëri prej tyre nuk shkon në punë, ai ndihmon në bërjen e punëve të shtëpisë. Bashkëshorti që shkon në punë, ose që fiton më shumë para duhet t'i jap partnerit të holla të nevojshme për mbajtjen e shtëpisë së përbashkët si dhe për nevojat personale të rëndomta. Nëse bashkëshorti që fiton më shumë para nuk pranon, ai/ajo mund të detyrohet t'i paguajë alimentacion bashkëshortit tjetër. Në ligjin finlandez është përcaktuar e drejta për alimantacion, dmth ndihmë me të holla, shumica e të cilit konfirmohet me marrëveshje ose me vendim gjyqi.

Influenca e martesës në pasuri

Bashkëshortët vendosin vetë për pasurinë e tyre. Sipas ligjit finlandez të dy bashkëshortët janë zotërues të asaj pasurie që ata kishin kur u martuan, ose që e kanë fituar gjatë martesës. Por bashkëshorti nuk mund të shesë pasurinë e përbashkët të shtëpisë pa pëlqimin e tjetrit, psh, banesën e përbashkët, mobiljet, ose sendet e fëmijëve.

Nëse bashkëshorti merr vetë hua, ai është vetë përgjegjës për shlyerjen e saj. Por kur huaja është e përbashkët ose huaja është marrë për pagimin e alimentacionit, atëhere të dy bashkëshortët janë përgjegjës për të.

Pasuria e bashkëshortëve gjykohet sipas ligjeve të atij shteti ku është lidhur martesë. Nëse më vonë bashkëshortët shpërngulen për të jetuar në shtet tjetër, atëhere ndiqen ligjet e atij shteti. Por ligjet e shtetit të ri zakonisht hyjnë në fuqi vetëm pas pesë vjet banimi në atë shtet.

Në qoftë se bashkëshortët vendosen përgjithmonë në Finlandë, atëhere pasuria e martesës së tyre gjykohet sipas ligjeve finlandeze. Nëse çifti ka jetuar diku tjetër dhe pastaj rransferohen në Finlandë, ligji finlandez hyn në fuqi vetëm pasi ata të kenë jetuar 5 pesë vjet në Finlandë. Para kësaj ligjet e shtetit ku çifti ka jetuar mbeten ende në fuqi. Në rast se bëhet fjalë për të riatdhesuar, ligji finlandez hyn në fuqi menjëherë kur ata vendosja e tyre në Finlandë të jetë e natyrës së përhershme.

Megjithatë bashkëshortët mund të bëjnë marrëveshje me shkrim që pasuria e tyre të gjykohet, për shembull, sipas ligjeve të shtetit, ku bashkëshortët janë nënshetas, ose sipas ligjeve të shteteve nga vijnë. Bashkëshortët që transferohen në Finlandë mund të merren vesh, për shembull, që ligjet finlandeze të gjykojnë pasurinë e tyre para se të plotësohet 5 vjet nga banimi i tyre në Finlandë. Për hartimin e marrëveshjes është mirë të kërkohet ndihmë **nga zyra e ndihmës legale, avokati ose juristi**.

E drejta e trashëgimisë

Në Finlandë gratë dhe burrat e trashëgojnë pasurinë njësoj. Fëmijët dhe pasardhësit e tyre kanë të drejtë të trashëgojnë pasurinë e prindërve pas vdekjes së tyre. Nëse pas vdekjes së bashkëshortit nuk ka fëmijë ose pasardhës të tyre, bashkëshorti që jeton trashëgon të gjithë pasurinë e atij që ka vdekur.

Megjithatë ky rregull nuk realizohet kur bashkëshorti ka caktuar ndryshe në **testament**. Duke bërë testament, njerëzit influencojnë se c'do të bëhet me pasurinë e tyre pasi ata të vdesin.

Përgjithësisht emigranti ka të njëjtat të drejta lidhur me trashëgiminë si dhe nënshetasi finlandez. Trashëgimia gjykohet sipas ligjeve të atij shteti ku i ndjeri ka jetuar. Në testament mund të përcaktohet dhe ligjet që e përcaktojnë atë.

Mbi çështjet e trashëgimisë dhe lënies së testamentit mund të kontaktoni për shembull, **zyrat e ndihmës legale**, si dhe **juristët**.

BASHKËJETESA

Me bashkëjetesë kuptohet marrëdhënia kur bashkëshortët jetojnë bashkë, por nuk janë të martuar me njëri tjetrin. Bashkëjetesa është një formë e zakonshme jetese në Finlandë. Në shumë raste bashkëjetesa njësohet me martesën, për shembull, në çështjet e mbrojtjes sociale. Megjithatë, sipas ligjit finlandez bashkëjetesa ndryshon nga martesë si më poshtë:

- Fëmijët e çifteve në bashkëjetesë nuk kanë të njëjtën pozitë si ata të çifteve të martuara, por të drejtat e tyre garantojnë në bazë të atësisë. (shih faqen 5)
- Nëse bashkëshortët ndahen, secili prej tyre mba pasurinë vetjake, në rast se për të nuk është bërë marrëveshje ndryshe.
- Bashkëshortët nuk trashëgojnë asgjë nga njëri-tjetri, nëse nuk kanë testament të shkruar mbi këtë.

Në bashkëjetesë është me rëndësi të sqarohet se si do ndahet pasuria në rast divorci, ose vdekje të njërit prej bashkëshortëve. Marrëveshjet mbi pasurinë duhen bërë me shkrim.

Bashkëjetesa dhe leja e qëndrimit

Bashkëjetesa është kusht i mjaftueshëm për marrjen e lejes së qëndrimit në rast se personi që jeton në Finlandë dhe bashkëshorti/ja kanë jetuar bashkë së paku dy vjet, ose në rast se ata kanë fëmijë të përbashkët. Leja nuk jepet nëse njëri prej bashkëshortëve është ende i martuar me dikë tjetër.

3. FËMIJËT

Qëllimi i politikës familjare finlandeze është të krijojë për fëmijën një ambient të sigurtë edukimi, si dhe të garantojë për prindërit mundësitë materiale dhe shpirtërore për të lindur e rritur fëmijët. Në ditët e sotme i jepet rëndësi barazisë së prindërve në rritjen e fëmijëve. Ndarja e përgjegjësisë lehtëson jetën në punë dhe harmoninë e familjes, si dhe pasuron jetën e burrit.

Sipas legjislacionit finlandez fëmija duhet trajtuar si individ i barabartë. Rrahja e fëmijës, ose abuzimi fizik janë të ndaluara me ligj. Të drejtat e fëmijëve janë njësoj si për fëmijët e ardhur nga jashtë shtetit ashtu edhe për ata finlandezë. Vajzat dhe djemtë kanë të drejta të njëjta në Finlandë.

Planifikimi i familjes

Lindja e fëmijës është një vendim i përbashkët i gruas dhe burrit, dhe kjo dëshirohet të realizohet në një kohë të përshtshme për ta. **Qendrat shëndetësore dhe këshillimet për familje e parandalim** ofrojnë ndihmë për gra e për burra në planifikimin familjar, madje edhe falas. Mjete parandaluese mund të bleni nga dyqane ushqimore dhe barnatore.

Për gruan rekomandohen vizita të rregullta te **gjinekologu**. Gjithashtu, në rast se dëshironi është e mundur të bisedoni për mundësi të ndryshme preventimi. Shërbimet gjinekologjike të qendrës shëndetësore janë më të lira se ato të mjekut privat. Gruaja ka mundësi të kërkojë për tu vizituar te gjinekologe. Për të ditur nëse jeni shtatzënë mund të bëni testimin te qendra shëndetësore, ose mund të bleni vetë testin e shtatzënisë nga barnatorja.

Aborti

Në Finlandë aborti është i mundur të bëhet kur lindja përbën rrezik për jetën e nënës, ose kur shtatzënia dhe lindja janë mundim tejet i madh për të. Nëse gruaja dëshiron ajo mund të abortojë gjithmonë kur është nën moshën 17 vjeç, ose mbi 40 vjeçe. Shtatzënia mund të ndërpritet vetëm me kërkesë të nënës. Ndërprerja e shtatzënisë për arsye shoqërore duhet bërë përpara se shtatzënia të ketë kaluar javën e 12:të. Në rast se kërkon abort duhet të lajmëroni mjekun sa më shpejtë të jetë e mundur.

LINDJA E FËMIJËS

Është me rëndësi që nënat shtatzënë të vizitohen në **këshillimoren** (e nënave shtatzëna) ose te mjeku para se mbarimit të muajit të katërt të shtatzënisë. Vetëm nënat që shkojnë me kohë në kotrollin mjekësor kanë të drejtë për ndihmën amësore. Si kusht paraprak për të hollat e nënës shtatzënë duhet vërtetimi nga këshillimorja ose mjeku mbi zgjatjen e shtatzënisë (shih faqen 6).

Nëpërmjet vizitave të rregullta në këshillimore ndiqet gjendja e nënës dhe fëmijës gjatë shtatzënisë. Kontrollat në këshillimore janë falas. Edhe baballarët mund jenë prezent gjatë kontrolleve. Njohuri dhe përgatitje mbi lindjen e fëmijës jepet në këshillimore si dhe në kurse për të dy prindërit të cilët organizohen nga **qendrat shëndetësore**.

Në Finlandë lindja bëhet në **spitalet e lindjeve** (maternitete). Edhe baballarët kanë mundësi të jenë prezent gjatë lindjes, shumë baballarë finlandezë dëshirojnë të marrin pjesë në lindje për të mbështetur nënat.

Babai i fëmijës

Fëmija ka të drejtë për siguri materiale dhe shpirtërore nga të dy prindërit. Për sigurimin e të drejtave të fëmijës është e rëndësishme të dihet se kush është babai i fëmijës. Sipas ligjit finlandez bashkëshorti në martesë është babai i fëmijës të çiftit të martuar. Kur fëmija lind jashtë kurore, atësia e fëmijës sqarohet nga **mbikqyrësi komunal për fëmijë**, në rast se nuk ka kundërshtim nga nëna. Edhe atësinë e fëmijës të lindur në bashkëjetesë sqarohet te mbikqyrësi komunal për fëmijë. Pasi të konfirmohet atësia fëmija ka të njëjtat të drejta si fëmija i lindur në martesë (kurorë).

Nënshtetësia e fëmijës

Fëmija merr nënshtetësi finlandeze në lindje në qoftë se

- nëna e fëmijës është në momentin e lindjes nënshtetase finlandeze
- babai i fëmijës është nënshtetas finlandez dhe i martuar me nënën, nënshtetase e huaj, e fëmijës
- babi i fëmijës ka vdekur, por në momentin kur ka vdekur ka qenë nënshtetas finlandez dhe i martuar me nënën e fëmijës
- fëmija lind në Finlandë dhe kur lind nuk ka nënshtetësinë e asnjë shteti tjetër

RRITJA DHE PËRKUJDESI PËR FËMIJËN

Eksperienca tregon se dygjuhësia dhe dykulturësia e fëmijëve të emigrantëve janë dobi në të ardhmen. Prindërit mund të ndikojnë te fëmija duke i folur atij, sipas rastit, në gjuhën amtare dhe duke e njohur atë me kulturën e vendit të tij. Fëmijët e mësojnë gjuhën dhe kulturën finlandeze jashtë shtëpisë, në çerdhe dhe shkollë.

Kujdesi mjekësor për fëmijë

Shoqëria merr pjesë në kujdesin mjekësor të fëmijës së bashku me prindërit. Që prej lindjes e derisa të bëhet 7 vjeç shëndetin e fëmijës dhe të nënës e ndjekin në **këshillimore** me intervale të rregullta. Në këshillimore jepen vaksinimet e nevojshme si dhe këshilla lidhur me kujdesin e rritjen e fëmijës e me të qënurit prind. Prindërit mund të pyesin në këshillimore mbi çështje që ju interesojnë. Nga **këshillimorja për prindër** mund të kërkonit dhe shërbimet e psikiatrit për fëmijë ose të logopedit (terapisti për të folurën). Për fëmijët e moshës shkollë kujdesen **motra medicinale, mjeku dhe dentisti i shkollës** në bashkëpunim me prindërit.

Bërja synet e vajzave është e ndaluar

Në Finlandë gjymtimi i organeve seksuale të vajzave dhe grave është veprim i dënueshëm me ligj për të cilin mund të dënohesh me shumë vjet burgim. Ndërsa bërja synet e djemve nuk është e ndaluar në Finlandë. Megjithatë bërja synet e djalit vihet në pyetje, nëse djali është aq i rritur sa për ta dhënë vetë pëlqimin për synetinë. Në Finlandë djemtë e moshës shkollore zakonisht konsiderohen të rritur aq sa për të marrë parasysh mendimin e tyre në çështje të tilla.

Operacionet e synetllëkut për çështje fetare nuk konsiderohen si mjekim shëndetësor, prandaj ato nuk bëhen në qendrat shëndetësore komunale. Synetllëku duhet bërë në vende ku sigurohen aftësitë mjekësore profesioniste mjekësore, higjiena dhe ilaçet e mpirjes.

Mbështetja financiare për familjen e fëmijës

Familjes që ka fëmijë i ndihmohet në të ardhurat e tyre me anën e mbështetjeve të ndryshme financiare. Një pjesë e këtyre përfitimeve i takojnë të gjithë atyre që banojnë në Finlandë. Një pjesë tjetër i takon vetëm atyre që kanë jetuar në Finlandë për një kohë më të gjatë.

- **Ndihma amësore (äitiysavustus)** i jepet çdo nëne që jeton në Finlandë e që është vizituar rregullisht në këshillimore ose te mjeku para përfundimit të muajit të katërt të shtatzënisë. Ndihma mund të merret në formën e të hollave ose si paketë amësore e cila ka rroba dhe mjete të nevojshme kujdesi për fëmijën e porsalindur.
- **Të hollat prindore (vanhempainpäiväraha)** i paguhen prindit i cili/e cila kujdeset në shtëpi për foshnjën gjatë 10 muajve të parë. Të hollat ditore përbëhen nga të hollat amësore, atërore dhe prindore. Për këto mbështetje kanë të drejtë të gjithë ata që jetojnë në Finlandë me banim të përhershëm të paktën 180 ditë para kohës së llogaritur të lindjes. Prindërve që shkojnë në punë u paguhen para ditore minimale.
- Shpenzimet që ju shkaktohen familjes me fëmijë lehtësohen, gjithashtu, me anë të **shtesave për fëmijë (lapsilisä)**, të cilat paguhen çdo muaj për secilin fëmijë të moshës nën 17 vjeç me banim të përhershëm në Finlandë.

Njohuri të mëtejshme dhe aplikime mbi përfitimet e familjeve me fëmijë mund të merrni nga zyrat e **Institutit të Sigurimeve (KELA)**. Edhe nga **këshillimorja për nëna** mund të informoheni se nga merren të tilla përfitime.

KUJDESI DITOR

Në Finlandë është e zakonshme që fëmijët të jenë gjatë ditës jashtë shtëpisë, **në kujdesin ditor**. Në çerdhe mbështetet zhvillimi i ekuilibruar dhe i shumëllojshëm i fëmijës. Njëkohësisht mundohet të ndihmohen të dy prindërit, në mënyrë të barabartë të kenë mundësi për të marrë pjesë në punë dhe shkollim. Prindërit mund ta organizojnë kujdesin për fëmijën në tre mënyra:

- 1) Nëna ose babai mund ta lerë punën për tu kujdesur për fëmijën në shtëpi duke marrë leje pa të drejtë rroge. Prindi që kujdeset për fëmijën mbështetet ekonomikisht me anë të **asistencës për kujdesjen shtëpiake (kotihoidon tuki)** deri sa fëmija të mbushë moshën tre vjeç.
- 2) Fëmija mund të jetë në kujdesin e **kujdestarit privat** ose në **çerdhe**. Prindërve ju kompensohet një pjesë e shpenzimeve me anë të **asistencës për kujdes privat (yksityinen hoidon tuki)**.

- 3) Komuna organizon për fëmijët e moshës parashkollore vendin e përkujdesit që mund të jetë në **çerdhe** ose në **çerdhe familjare**. Shpenzimet ditore për kujdesin llogariten në bazë të të ardhurave familjare. Për familjet me pak të ardhura ky kujdes është falas.

Bashkëpunimi mes çerddes dhe prindërive është i rëndësishëm

Kujdesit ditor gjithashtu ndihmon fëmijët e emigrantëve në zhvillimin e gjuhës dhe kulturës amtare, si dhe në fuqizimin e identitetit të tyre shumëkulturore. Është e rëndësishme që prindërit të bisedojnë me personelin e çerddes mbi edukimin e fëmijës dhe të merren vesh për hollësitë lidhur me to.

Njohuri të mëtjshme për kujdesin ditor të fëmijëve mund të merrni nga **informacioni për kujdesin ditor komunal**. Nga zyrat e **Institutit të Sigurimeve (KELA)** mund të pyesni mbi forma të ndryshme të mbështetjes së kujdesit ditor për fëmijë.

SHKOLLA

Të gjithë fëmijët me banim të përhershëm në Finlandë janë të deytuar të shkollohen. Kjo do të thotë që edhe fëmijët e emigrantëve duhet të kryejnë shkollën 9-vjeçare fillore. Para fillimit të shkollës fëmijët mund të marrin pjesë në arsimin parashkollor të organizuar nga çerdhja ose shkolla. Shkolla fillore fillohet zakonisht në vitin kur fëmija mbush 7 vjeç. Vajzat e djemtë kanë mundësi të barabarta të ndjekin shkollën. Arsimi fillor, materialet mësimore, ushqimi në shkollë dhe kujdesi shëndetësor janë falas.

Në shkollë përkrahjet kultura e emigrantëve

Në shkollë mundohet të merret parasysh identiteti kulturor i emigrantit e të mirëmbahet duke mbështetur kulturën e tij. Para kalimit në klasën shkollore, fëmijës është e mundur t'i organizohet mësim përgatitor në grupe të veçanta. Fëmijët me gjuhë të huaj mund të marrin përveç mësimin normal, mësim shtesë në gjuhën e tyre amtare. Sipas ligjit fëmija ka të drejtë të mësojë në shkollë gjuhën e vet amtare të paktën dy orë në javë.

Prindërit mund të merren vesh me shkollën, midis të tjerash si për mësimin fetar ashtu dhe për dietën e veçantë ushqimore të fëmijës. Shkollat bashkëpunojnë me shtëpitë. Të gjithë prindërit duhet të marrin pjesë në mbledhjet me prindër, në bisedat me mësues e motra medicinale, si dhe në aktivitetet e shoqatës së prindërve.

Për çështjet e shkollës mund të bisedoni me **drejtorinë e shkollës**, ose **entën e arsimit** si dhe me **personelin e shkollës** së komunës ku banoni.

4. SHKOLLIMI

Në Finlandë vlerësohet shkollimi. Shkollimi ka rëndësi parësore për punësimin dhe në shumicën e profesioneve kërkohet shkollim. Gjithashtu shkollimi përmirëson dhe në barazinë midis gruas dhe burrit. Njeriu i shkolluar ka kushte paraprake më të mira për të punuar në shoqëri dhe të kujdeset për veten e tij.

Në Finlandë dëshirojmë që secilit t'i jepen mundësi të barabarta për shkollim dhe zhvillimin e vetes pavarësisht nga gjinia, etniciteti, ose pasuria.

Me anë të mbështetjeve financiare për shkollim si dhe me organizimin e kujdesit ditor ndihmohet në krijimin e mundësive të barabarta për shkollim. Falë këtyre organizimeve shkollimi i grave në Finlandë është i përhapur. Me anë të studimit emigrantët mund të marrin njohuri dhe aftësi të nevojshme në shoqërinë finlandeze, si dhe të mirëmbajnë e të zhvillojnë gjuhën dhe kulturën e tyre.

Shkollim gjatë gjithë jetës

Në Finlandë ecet sipas parimit të shkollimit gjatë gjithë jetës. Me këtë kuptohet marrja dhe përmirësimi i njohurive e aftësive dhe në moshë të rritur. Shkollimi shtesë shërben që niveli profesional i atyre që punojnë tu përgjigjet kërkesave të punës të cilat janë duke ndryshuar vazhdimisht.

Mësimi i gjuhëve

Personi që shpërngulet në Finlandë duhet të mësojë finlandisht ose në disa komuna suedisht. Ka shumë institute shkollore që organizojnë kurse në finlandisht e suedisht për të huaj. Përveç pjesëmarrjes në kurse të gjuhës, gjuhën mund ta ushtroni duke folur aktivisht me finlandezë, sidomos në aktivitete të kohës së lirë. Njohuritë gjuhësore dhe njohja me njerëz të ndryshëm ndihmojnë në përshtatjen me vendin e ri.

Shkollimi i kryer jashtë shtetit

Shkollimi dhe eksperiencia e punës e kryer jashtë shtetit janë bazë për planifikimin e shkollimit plotësues në Finlandë. Diplomat shkollave të larta të kryera jashtë shtetit mund të njihen ose njësohen me diplomat respektive finlandeze nga **Drejtoria për Arsim**. Gjithashtu, Drejtoria për Arsim mund të lëshojë dëshmi që shkollimi i kryer jashtë përputhet me atë në vend. Këto shërbime janë me pagesë. Nëse studenti dëshiron të vazhdojë diplomën që ka kryer në institucionet shkollorë finlandezë, atëhere institucioni në fjalë shqyrton vlefshmërinë e diplomës së mëparshme për ta përdorë atë si bazë për diplomën e re.

Mundësia për shkollim

Në Finlandë pas kryerjes së shkollës fillore nëntëvjeçare rruga më e zakonshme për të vazhduar studimet është në **gjimnaz** i cili jep kulturë të përgjithshme, ose në **shkolla profesionale**. Pas kësaj mund të vazhdohet për në **shkolla të larta, shkolla të larta profesionale** ose **universitet**.

Personat që shpërngulen nga jashtë shtetit për në Finlandë mund të kryejnë shkollën fillore dhe gjimnazin psh në **gjimnazet për të rritur** ose në **institutet popullore**. Përveç këtyre, në Finlandë ka shumë **qendra të shkollimit për të rritur**, ku të rriturit mund të specializohen në një profesion ose të plotësojnë diplomat e mëparshme. Para se të marrin pjesë në shkollimin profesional emigrantët duhet të përmirësojnë njohuritë e tyre gjuhësore dhe shkollore duke dhënë lëndë plotësuese dhe përgatitore në institucione të ndryshme. Profesionit mund të merret edhe me anë të **mësimit me kontratë**. Për të papunët organizohen **shkollime për fuqinë punëtore** me kohëzgjatje të ndryshme, ku mund të marrin pjesë, nëpërmjet entit të punësimit dhe emigrantët.

Plani i integrimit ndihmon për tu integruar

Nëse personi i shpërngulur në Finlandë nuk gjen as punë as vend shkollimi, atij mund t'i bëhet plani i integrimit në **entit e punësimit** ose në **zyrën sociale**. Qëllimi i këtij plani është të ndihmojë në punësimin e emigrantit si dhe në integrimin e tij në shoqërinë finlandeze.

Emigranti bashkëpunon në bërjen e planit me zyrtarin e entit të punësimit ose me punëtorin e socialit. Në plan merren parasysh dëshirat e aplikantit, situata e jetës si dhe aftësitë profesionale. Plani i integrimit përmban shpeshherë mësimin e gjuhës finlandeze, kualifikim profesional ose praktikë pune. Ndonjëherë në plan hyn edhe fillimi i një profesioni krejt të ri. Plani i integrimit zgjat 3 vjet.

Gjatë kohës së realizimit të planit të integrimit kur emigranti nuk ka të ardhura të tjera, shpenzimet e jetesës garantojnë nga **asistenca e integrimit (kotoutumistuki)**. Kusht paraprak për marrjen e kësaj asistence është zbatimi i planit të integrimit.

Shkollimi i integrimit

Në shumë komuna organizohen shkollime gjashtëmujore të integrimit për të rritur emigrantë. Në shkollim mësohet finlandisht, jepen njohuri mbi shoqërinë finlandeze, orientime mbi shkollimin e jetën në punë, si dhe organizohet punë praktike. Për secilin nxënës bëhet plani vetjak mësimor ose plani i punësimit. Objektivi parësor janë emigrantët e papunë. Edhe për analfabetët organizohen shkollime të veçanta në disa komuna.

Enti i punësimit jep informata të mëtejshme për mundësi të ndryshme shkollimi, për planin dhe shkollimin e integrimit.

Bursa shkollore

Në Finlandë situata financiare e studentëve ndihmohet me anë të bursës shkollore. I huaji me banim të përhershëm në Finlandë, që ka banuar në Finlandë së paku dy vjet me arsye të tjera qëndrimi, merr bursë shkollore nëse mësimi është veprimtari kryesore e tij. Bursë shkollore mund të marrin dhe refugjatët e anëtarët e familjeve të tyre, ose personë të riatdhesuar që janë shpërngulur në Finlandë, ndonëse nuk kanë jetuar dy vjet këtu. Edhe personat e shpërngulur në Finlandë nën moshën 18 vjeç mund të marrin bursë shkollore menjëherë pas shpërnguljes, nëse prindërit janë me banim të përhershëm në Finlandë.

Informata të mëtejshme mbi bursën shkollore jep **Instituti i Sigurimeve (KELA)**.

5. PUNA

Në Finlandë gratë dhe burrat kanë të njëjtat të drejta, detyrime dhe mundësi për punë. Është më se e zakonshme që gratë të jenë në punë me rrogë dhe të jenë sipërmarrëse, jashtë shtëpisë. Pjesëmarrja në punë mundëson pavarësinë financiare të gruas.

Barazia në punë

Në ligjin e barazisë i kushtohet vëmendje të veçantë përmirësimit të pozitës së gruas në punë. Ligji detyron punëdhënësin të lehtësojë përshtatjen e punës me shtëpinë. Qëllimi është të krijohen mundësi të barabarta si për burrat ashtu dhe për gratë të pjesëmarrin si në jetën shtëpiake dhe në punë.

Në Finlandë është e ndaluar me ligj diskriminimi në punë me bazë gjininë, origjinën etnike, fenë ose moshën. Secilit dëshirojnë t'i garantojnë trajtim të barabartë në kërkimin e punës dhe në punë. Qëllimi është që emigrantët të marrin pjesë si anëtarë të barabartë në punë dhe aktivitete të tjera të shoqërisë.

Mos harroni lejen e punës

Në Finlandë emigrantët kanë nevojë, me përjashtim të disa rasteve për lejen e punës e cila lëshohet nga **Drejtoria për të Huaj**.

Kërkimi i punës

Kur të filloni kërkimin e punës do të gjeni ndihmë nga **zyrat e entit të punësimit**, ku ka punëtorë të specializuar për emigrantë. Menjëherë pas shpërnguljes në Finlandë ja vlen të lajmëroheni si i papunë në entin komunal të punësimit. Prej tij mund të merrni informata për vende e praktika pune si dhe për mundësi shkollimi të ndryshme. Gjatë kërkimit të punës është e rëndësishme që personi të jetë aktiv dhe të kontaktohet me punëdhënës.

Rroga

Të ardhurat me anë të punës janë pasuri personale e secilit person. Zakonisht punëdhënësi e paguan rrogën e punëtorit në llogarinë personale bankare që ai ka lajmëruar. Llogaria bankare hapet në bankën e dëshiruar dhe për të duhet të keni pasaportë të vlefshme ose letërnjoftim.

Tatimet

Secili punëtor që jeton në Finlandë i paguan tatim shtetit dhe komunës ku banon. Ata që kanë të ardhura më të mëdha paguajnë më shumë se ata që kanë më pak. Punëdhënësi kujdeset për pagesën e tatimeve nga ana e punëtorit duke u bazuar në dëshminë tatimore. Punëtori duhet t'ja dorëzojë dëshminë tatimore punëdhënësit që kur të fillojë punën.

Para se të fillojë punën e parë emigranti duhet të marrë dëshminë tatimore të komunës ku banon nga zyra e tatimeve. Është me rëndësi që të lajmërohesh si emigrant. Pas vitit të parë dëshmia tatimore nuk ka nevojë të merret, sepse dërgohet me postë në shtëpi.

Sigurimet shoqërore

Me paratë e mbledhura nga tatimet financohet, midis të tjerash, sigurimi shoqëror. Zakonisht në Finlandë gratë dhe burrat mbajnë me anë të punës veten dhe familjen e tyre. Megjithatë kjo nuk është gjithmonë e mundur për shkak të papunësisë, plakjes, invaliditetit ose sëmundjes. Në të tilla situata shoqëria mundohet të sigurojë të ardhurat e personit. **Instituti i Sigurimeve (KELA)** kujdeset për shumicën e sigurimeve për të cilat kanë të drejtë të gjithë ata që kanë banim të përhershëm në Finlandë pavarësisht nga nënshtetësia e tyre.

Dobia e punës pasqyrohet edhe te pensioni

Të ardhurat e rrogës marrë nga puna ndikojnë në pavarësinë financiare edhe në të ardhmen. Nëse ai që ka punuar mbetet i papunë, kompensimi i tij i papunësisë është i varur nga të ardhurat dhe më i lartë për ata që kanë punuar sesa për ata që kanë qenë të papunë për një kohë të gjatë. Gjithashtu rrogëtarët që kanë marrë më shumë rroga gjatë jetës kanë mundësi të marrin pensione më të larta. Sigurimi shoqëror i atyre që kanë punuar në shumicën e rasteve nuk varet nga të ardhurat e bashkëshortit/es.

Veprimtaritë e kohës së lirë

Megjithë aktivitetin tuaj ndonjëherë punë nuk gjehet. Në raste të tilla nuk ka pse të trembeni dhe të veçoheni duke ndenjur në shtëpi. Në Finlandë ka mundësi të shumta për të ushtruar aktivitete të ndryshme dhe për të bërë, për shembull punë vullnetare ose punë në organizata të ndryshme. Në shumë komuna janë organizuar aktivitete vetëm për gra. Kultura juaj mund të kultivohet në bashkimet e emigrantëve dhe në vendtakime shumëkulturore, ku mund të takoheni me shumë njerëz. Puna vullnetare dhe në organizata mundëson mirëmbajtjen dhe zhvillimin e njohurive dhe aftësive personale dhe kjo mund të ketë në të ardhmen rëndësi të madhe për punësimin tuaj.

Informata të mëtejshme për hobi mund të merrni, për shembull, nga **zyrat e kulturës dhe aktiviteteve të lira**, nga **shoqata e organizata** të ndryshme, si dhe nga **shpalljet në gazetatat lokale**.

6. VËSHTIRËSITË NË JETËN FAMILJARE

Në jetën e çdo familje hyjnë jo vetëm gëzimi por edhe konfliktet e vështirësitë. Ndonjëherë fuqitë dhe mundësitë personale nuk mjaftojnë për zgjidhjen e problemeve. Në këtë rast është mirë të kërkonit zgjidhje në bashkëpunim me njerëz profesionistë të jashtëm, përpara se problemet të bëhen tejet të mëdha.

NDIHMË NË RAST KONFLIKTESH

Në të gjitha komunat e Finlandës ka këshillimore edukimi dhe familjare, të cilat ofrojnë ndihmë në marrëdhëniet njerëzore, familjare dhe në çështjet e edukimit të fëmijës. Një formë e ndihmës së këshillimoreve familjare është pajtimi vullnetar i çështjeve familjare, e për këtë ndihmë mund ta informoheni nga zyrat komunale të socialit. Në pajtimet e çështjeve familjare anëtarët e familjes mundohen të gjejnë një zgjidhje të barabartë dhe të përshtatshme për të gjithë anëtarët, së bashku me punëtorin social dhe psikologun. Në pajtime mund të marrë pjesë gjithë familja ose një pjesë e tyre. Proçesi i pajtimit mund të përdoret si mjet për zgjidhjen e çfarëdo konflikti familjar, përfshi këtu edhe problemet e divorcit.

Proçesi i pajtimit familjar që organizohet nga komuna është falas dhe bisedimet janë tërësisht konfidenciale. Përveç komunave edhe kishat, bashkësi e persona të specializuar në punën e këshillimoreve familjare organizojnë proçese pajtimi.

Problemet psiqike

Shpërngulja në vend të ri dhe përshtatja ndaj rrethanave të reja mund të jetë shpirtërisht e vështirë. Mund të mendosh ende mbi vështirësitë e kaluara në atdhe si dhe për fatin e të afërmeve që mbetën atje. **Zyrat komunale të psiqiatisë** japin këshilla dhe kujdes për problemet psiqike. Shërbimet janë falas për banorët e komunës.

Në Helsinki funksionon gjithashtu dhe **Qendra e krizës për të huaj (Ulkomaalaisten kriisikeskus)** e cila i shërben të gjithë emigrantëve dhe familjeve të tyre që banojnë në Finlandë. Prej kësaj qendre merrni shërbime falas lidhur me problemet psiqike dhe sociale. Për refugjatë të cilët kanë qenë viktimë e torturimeve në atdhe dhe të afërmit e tyre kujdeset falas **Qendra e rehabilitimit për të torturuar (Kidutettujen kuntoutuskeskus)**. Këto shërbime duhen rezervuar gjithmonë paraprakisht.

Strehimoret për nëna me fëmijë

Lindja e fëmijës të parë përbën për familjen një fazë të re të jetës si dhe mësimin e shumë gjërave të reja. Ndonjëherë gjatë lindjes së fëmijës në familje ka probleme të veçanta si krizë familjare ose mungesë banese. **Strehimoret (ensikoti)** janë shtëpi për nëna me fëmijë që kanë për detyrë përkrahjen e nënave me fëmijë në situata të vështira. Në këto strehimore mund të shkojnë nënat shtatëzën dhe ato që kanë lindur bashkë me fëmijën. Në strehimore për nëna me fëmijë jepen udhëzime mbi kujdesin për fëmijën dhe rolin e nënës, si dhe ndihmohet që prindi të mësohet të jetë i pavarur. Koha e banimit në strehimore për nëna me fëmijë varion. Zakonisht nëna dhe fëmija jetojnë në strehimore gjashtë muaj.

Informata të mëtejshme mbi strehimoret për nëna dhe fëmijë mund të merrni prej **zyrës komunale të socialit dhe këshillimores**.

Problemet e fëmijëve dhe të rinjve

Fëmijët dhe të rinjtë përshtaten më shpejt me kulturën e re sesa të rriturit. Në ambientet e shoqërisë dhe të shkollës ata njehsohen me zakonet e reja të cilat prindërit mund të kenë vështirësi t'i kuptojnë. Përveç vështirësive të përshtatjes të kulturës së re me të vjetrën fëmijët mund të kenë vështirësi të tjera, jashtë shtëpisë, si për shembull, ngacmimi në shkollë. Me shtimin e problemeve ka rrezik që fëmijët të ekspozohen me drogë ose krime të tjera.

Për parandalimin e problemeve është e rëndësishme që prindërit të bisedojnë me fëmijët dhe të jenë në kontakt të ngushtë me çerdhen dhe shkollën e fëmijës. Edhe problemet më të vogla zgjidhur me kohë. Prindërit duhet të mos harrojnë se në Finlandë të rinjtë kanë të drejtë të marrin vendime që i përkasin jetës së tyre, për shembull, të zgjedhin vetë bashkëshortin/en e tyre.

Për probleme me fëmijët dhe të rinjtë mund të kërkonit ndihmë nga **këshillimoret komunale familjare** dhe nga **zyrat për sëmundje psiqike**.

DHUNA FAMILJARE

Keqtrajtimi i bashkëshortes/it ose i fëmijës është dhunë familjare. Dhuna familjare është, sipas ligjit të Finlandës, krim për të cilin nuk mund të shfajësohesh duke përmendur zakonet kulturore. Personi që bie viktimë e kësaj dhune duhet të lajmërojë policinë dhe të shkojë për kontroll te mjeku.

Është me rëndësi të ndalohet dhuna

Në Finlandë edhe dhuna që ndodh brenda shtëpisë është krim i gjykueshëm penalisht. Kjo do të thotë që ngritja e padisë kundër dhunës në shtëpi nuk varet nga vendimi i viktimës. Prokurori ngre padinë, duke përjashtuar rastet kur viktima e kundërshton atë me forcë dhe nëse akti nuk është i rëndë.

Dhuna e ushtruar kundrejt bashkëshortes/it ose fëmijës mund të jetë fizike, shpirtërore, ekonomike ose seksuale. Shpesh format e ndryshme të dhunës shfaqen bashkë.

- Dhunë fizike është për shembull, goditja, shtyrja, shqelmimi dhe furja
- Dhunë shpirtërore është kërcënimi, akuzimi, përbuzja, nënshtrimi, frikësimi si dhe kufizimi i lëvizjes ose i marrëdhënieve shoqërore dhe fafëfisnore.
- Dhunë ekonomike është kur bashkëshortja/ti nuk lejohet të shkojë në punë dhe nuk i jepen të holla për të jetuar.

- Dhunë seksuale është prekja seksuale e bashkëshortes/it kundër vullnetit të tij, forcimi për të bërë dashuri, ose përdhunimi.

Edhe dënimi fizik i fëmijëve është i ndaluar në Finlandë. Dhuna familjare nuk ndalon vetë, por në të shumtën e rasteve sa vjen e keqësohet. Megjithatë edhe për dhunën familjare ka ndihmë. Në komunat më të mëdha ka **strehimore (turvakoti)** që ndihmojnë viktimat e dhunës familjare e në të cilat mund të strehohesh edhe nëse banon në komuna të tjera. Mund të kërkosh për ndihmë edhe nga **zyra e socialit, qendra shëndetësore, zyra për sëmundje psiqike dhe këshillimores**, në komunën ku banoni. Për dhunën familjare mund të njoftoni dhe këshillimoren për nëna e fëmijë. Autoritet zyrtare e kanë për detyrë t'ju ndihmojnë.

Edhe keqtrajtuesi ka nevojë për ndihmë. **Autoritet zyrtare të komunës dhe profesionistë të specializuar në ndihmesën për ushtrues të dhunës** ndihmojnë ata që duan të shërohen nga sjellja me dhunë. Gjatë krizës së dhunshme viktimat dhe ushtruesi i dhunës duhet të trajtohen veçan, sepse viktimat mund ta ketë të vështirë të flasë për ndjenjat e veta kur keqtrajtuesi ndodhet prezent.

Strehimoret

Në strehimore mund të strehohet çdo viktimë e dhunës familjare. Në strehimore mund të shkohet menjëherë në rast krize ose situatë urgjente, ose mund të kontaktoheni me telefonon, ose më vonë nëpërmjet punëtorit tuaj të socialit. Nënata dhe fëmijët mund të banojnë përkohësisht në strehimore, në rast se jetesa në banesë është e rrezikshme ose e pamundur për shkak të dhunës, kërcënimit ose frikësimit. Bashkë me punëtorët e strehimores mund të mendoni për zgjidhjen e problemeve dhe mjete se si ta ndaloni dhunën. Zgjidhjet merren nga vetë klienti. Strehimoret dhe telefonat e tyre janë hapur gjatë gjithë ditës. Edhe komuna ka banesa në rast krize ose si strehimore.

Informata të mëtejshme për strehimoret dhe banesat si strehimore mund të merrni nga **zyra e socialit**. Natën dhe fundjavave informacion jep dhe **policia**.

Mund të mbroheni me ndalim-afrimin

Në Finlandë është në fuqi ligji për ndalim-afrimin. Me anë të ndalim-afrimit kuptohet që një njeriu t'i ndalohet kontaktimi me dikë tjetër me qëllim ruajtjen e jetës, shëndetit, lirisë ose qetësisë së këtij të fundit. Ndalim-afrimin mund ta marrësh për shembull atëherë kur ish-bashkëshorti/ja, ose personi me të cilin ke jetuar sillet kërcënueshëm.

Gjatë caktimit të ndalim-afrimit autoritete zyrtare vlerësojnë tregimin e aplikantit si dhe provat e mundshme, si dëshmitë mjekësore, kontaktet me policinë dhe tregimet e dëshmitarëve. Si shkak i rëndë për caktimin e ndalim-afrimit merret ushtrimi i dhunës. Megjithatë dhuna nuk është kusht paraprak për ndalim-afrimin.

Ndalim-afrimi nuk jepet mes personave që jetojnë në të njëjtën ekonomi familjare. Ndihmë për aplikimin e ndalim-afrimit merrni nga **autoritetet e zyrës së socialit**. Ndalim-afrimi kërkohet me gojë ose shkrim nga **policia** ose **gjyqi komunal**.

Përdhunimi


Sipas ligjit të Finlandës përdhunimi është krim. Edhe përdhunimi i bashkëshortit/es është krim. Viktima e përdhunimit duhet të kontaktojë **policinë** dhe të shkojë menjëherë te **mjeku** pasi të ketë ndodhur krimi. Viktima nuk është fajtor për përdhunimin dhe atij/asaj nuk duhet t'i vijë turp. Viktima e përdhunimit mund të kërkojë ndihmë nga autoritete komunale zyrtare lidhur me problemet e shaktuara nga përdhunimi. Në Helsinki **ndodhet Qendra për viktime të përdhunimeve, Tukinainen**, që mbulon tërë vendin.

DIVORCI


Martesa është marrëveshje e lirë e cila mund të priset. Nëse jeta e përbashkët duket e pamundur atëherë është e arsyeshme të kërkon divorc. Në Finlandë divorcet janë të zakonshme. Proçesi i divorcit fillohet duke plotësuar formularin e divorcit që e merr nga **gjqqi komunal** në komunën ku banoni. Gjyqi komunal nuk shqyrton arsyet e divorcit dhe as marrëdhëniet private midis bashkëshortëve. Divorci miratohet edhe në rastin kur njëri prej bashkëshortëve e kundërshton atë.

Divorci kërkohet në gjyqin komunal

MUNDËSIA 1



MUNDËSIA 2



Ndarja e pasurisë në divorc

Në përfundim të jetës së përbashkët vendoset për ndarjen e pasurisë, çështjet e fëmijëve (shih faqen 16) si dhe kush ka të drejtë të jetojë në banesën e përbashkët. Ndarja e pasurisë varet nga ligji i atij shteti që do të aplikohet në ndarje (shih faqen 3). Nëse aplikohet ligji finlandez në ndarjen e pasurisë atëherë të dy bashkëshortët do ta ndajnë barabar pasurinë mes tyre. Kjo quhet e **drejta e bashkëshortit/es**. Bashkëshortët mund ta ndajnë pasurinë duke ju përmbajtur marrëveshjes që kanë bërë së bashku. Nëse nuk arrihet marrëveshje mbi ndarjen e pasurisë atëherë gjykata cakton juristin për ta sqaruar atë.

Pasuria nuk ndahet barabar nëse bashkëshortët kanë bërë para ose gjatë martesës **kontratën e kushtëzimit të martesës**. Në kontratën e kushtëzimit të martesës bashkëshortët merren vesh që asnjëri prej tyre nuk ka të drejtë për të marrë pasurinë e tjetrit. Kështu secili bashkëshort mban gjatë divorcit atë pjesë të pasurisë për të cilën është marrë vesh në kontratën e kushtëzimit të martesës. Kontrata e kushtëzimit të martesës influencon në ndarjen e pasurisë edhe në rast se një prej bashkëshortëve vdes.

Kontrata e kushtëzimit të martesës duhet të bëhet me shkrim. Për hartimin e saj është e arsyeshme të kërkohet ndihmë nga **zyra e ndihmës legale** ose nga ndonjë **jurist**. Kontrata e kushtëzimit të martesës duhet regjistruar në **gjykatën komunale** në komunën ku banoni.

Influenca e divorcit në lejen e qëndrimit

Kur divorci hyn në fuqi vazhdimi ose anulimi i lejes së qëndrimit bëhet gjithmonë sipas rastit. Përfundimi i bashkëjetesës ose martesës influencon në lejen e qëndrimit vetëm nëse emigranti ka leje qëndrimi të përkohshëm, e cila është miratuar për arsye të lidhjeve familjare. Divorci nuk influencon te leja e qëndrimit e përhershme. Nëse leja e qëndrimit e përhershme bazohet në informata të rreme mbi bashkëjetesën ose martesën, atëhere divorci patjetër influencon në lejen e qëndrimit.

Miratimi i lejes së qëndrimit shqyrtohet gjithmonë me maturi. Autoritetet zyrtare marrin parasysh të gjitha argumentet që lidhen me çështjen gjatë marrjes së vendimit. Në vendimin përfundimtar influencon, gjithashtu, se ku i ka lidhjet më të mira emigranti, në Finlandë apo në shtetin e mëparshëm të banimit. Ish-bashkëshorti/ja finlandez nuk mund të kërkojë prej autoriteteve të anulojnë lejen e qëndrimit.

Nëse personi i divorcuar ka leje qëndrimi të përkohshme, zakonisht kërkohet dhe dy vjet qëndrimi në Finlandë, para se të vazhdohet leja përsëri. Nëse emigrantja është shtatzënë, ose ai/ajo ka fëmijë, vend pune, ose vendshkollim në Finlandë, atëhere vazhdimi i lejes së qëndrimit mund të shqyrtohet ndonëse emigranti ka jetuar më pak se dy vjet në Finlandë.

Por kushti i qëndrimit prej dy vjet në Finlandë nuk kërkohet nëse bashkëjetesa ose martesë ka përfunduar për shkak të dhunës fizike të njërit prej bashkëshortëve. Mbi dhunën fizike të bashkëshortit/es i duhen paraqitur sqarime të mjaftueshme autoriteteve zyrtare të lejeqëndrimit. Me sqarime kuptohet vërtetimi mjekësor mbi shenjat e dhunës fizike ose raporti i këshillimores familjare. Është mirë që formularit për lejen e qëndrimit t'i bashkangjitet edhe sqarimi i gjendjes nga vetë aplikanti.

Pozita e fëmijës në divorc

Detyra e kujdestarit të fëmijës është të përgjigjet për mirëqenien, edukimin dhe zhvillimin e ekuilibruar të fëmijës. Me kujdestari kuptohet e drejta për tu kujdesur për fëmijën dhe për të marrë vendime për fëmijën. Në rast nevojë kujdestari e përfaqëson fëmijën në gjykata dhe para autoriteteve zyrtare. Vetëm kujdestari mund ta ketë të shënuar fëmijën te pasaporta e vet.

Kujdestarët e fëmijës që lind në martesë janë të dy prindërit. Divorci i prindërve është shumë i vështirë për fëmijën dhe ai ka të drejtë që pas divorcit të marrë kujdes prej të dy prindërve. Në rast divorci synohet shpesh që prindërit të kenë **kujdestari të përbashkët**.

Nëse është e mundur, gjatë divorcit prindërit merren vesh mes tyre mbi kujdestarinë e fëmijës dhe çështjet e banimit. Kjo marrëveshje mund të konfirmohet në zyrën komunale të socialit, për shembull në **zyrën për çështjet familjare**. Nëse prindërit nuk arrijnë marrëveshje mes tyre, atëherë vendimi mbi kujdestarinë merret në gjykatë. Në vendimin e gjykatës influencon interesi i fëmijës dhe sqarimi i autoriteteve të socialit mbi prindërit.

Kujdestaria e përbashkët kërkon aftësi bashkpunimi nga të dy prindërit, ndonëse ata mund të kenë konflikte mes tyre. Nëse kushtet paraprake për kujdestarinë e përbashkët mungojnë, atëhere ajo prishet dhe njërit prej prindërve i caktohet **kujdestari e vetme mbi fëmijën**.

Në divorc trajtohen çështjet e fëmijës

MUNDËSIA 1

Kujdestaria e përbashkët (yhteishuoltajuus)

Në kujdestarinë e përbashkët prindërit rrisin bashkë fëmijën dhe bien dakort për çështjet e fëmijës pas divorcit. Në praktikë për shumicën e çështjeve vendos prindi me të cilin jeton fëmija. Megjithatë pëlqimi i kujdestarit tjetër kërkohet në vendime të cilat kanë të bëjnë me

- ndërrimin e vendbanimit të fëmijës (veqanërisht për jashtë shtetit)
- miratimin e pasaportës finlandeze
- intervenimet mjekësore
- ndryshimin e emrit ose të fesë
- shkollimin
- përdorimin e fondeve të fëmijës

MUNDËSIA 2

Kujdestaria e vetme (yksinhuoltajuus)

Kujdestari i fëmijës, pra njëri prej prindërve kujdeset vetëm për fëmijën dhe merr vendimet që kanë të bëjnë me të.

E drejta e takimit

Pavarësisht a kërkohet në divorc kujdestari e përbashkët apo e vetme, fëmija ka të drejtë të mbajë lidhje të afërta e të sigurta si me nënën ashtu edhe me babanë. Prindërit duhet së bashku të kujdesen që fëmija të takojë aq shpesh sa duhet prindin me të cilin nuk jeton. Takimi me prindin tjetër është e drejtë e fëmijës dhe ish-bashkëshorti/ja nuk mund t'ja ndalojë atë fëmijës.

Alimentacionet

Të dy prindërit janë të detyruar të kujdesen për jetesën e fëmijës. Nëse prindërit nuk jetojnë bashkë fëmija ka të drejtë për **alimentacion (elatusapu)** nga prindi që nuk jeton bashkë me fëmijën. Shuma e alimentacionit konfirmohet me kontratë të mbikqyrësi i fëmijës ose me vendim gjykate. Shuma e alimentacionit caktohet në bazë të mundësive financiare të paguesit të alimentacionit. Në rast se paguesi i alimentacionit nuk mund të paguajë alimentacionin e duhur, fëmija ka të drejtë të marrë **alimentacion subvencional (elatustuki)** nga komuna e banimit.

Informata të mëtejshme mbi pozitën e fëmijës në divorc japin **mbikqyrësit komunalë të fëmijës dhe zvara e socialit**.

Kujdes kur të nënshkruani kontrata

Para se të nënshkruani kontrata me shkrim dhe dokumentë të tjerë duhet të dini përmbajtjen e tyre. Kontratat e nënshkruara janë detyruese. Nëse njohuritë gjuhësore nuk mjaftojnë për kuptimin e kontratës atëherë duhet të kërkonit ndihmën e përkthyesit. Edhe kushtet e kontratës së punës është mirë t'i kuptoni para nënshkrimit të kontratës.

Për shembull, kontratat e divorcit dhe ndarjes së pasurisë mund të jenë shumë të komplikuar. Në hartimin e dokumentëve shpesh kërkohet ndihma e ekspertëve. Në Finlandë ndihmësit legale, avokatët dhe juristë të tjerë ofrojnë ndihmë për të gjitha çështjet legale. Ata që kanë pak të ardhura mund të kërkojnë ndihmë legale falas nga **zyrat e ndihmës legale**.

Informata për autoritetet zyrtare më të rëndësishme:

Përfaqësia për mbrojtjen e barazisë (Tasa-arvoaltuutetun toimisto)

Përfaqësia për mbrojtjen e barazisë mund të ndihmojë personin e diskriminuar në sigurimin e të drejtave të tij. Përfaqësia për mbrojtjen e barazisë mund të lëshojë dëshmi nëse ka ndodhur diskriminim me bazë gjinie apo jo. Detyrat e kësaj përfaqësie janë

- të mbikqyrë respektimin e ligjit të barazisë ku pasqyrohet barazia gjinore si dhe të mbikqyrë që diskriminime nuk ndodhin dhe të lajmërojnë raste të diskriminimit
- të përkrahë me anë të nismave, këshillave dhe instruksioneve qëllimin e ligjit
- të japë njohuri mbi barazinë dhe përshtatjen e saj në praktikë
- të ndjekë nga afër zbatimin e barazisë mes gruas dhe burrit në fusha të ndryshme të shoqërisë

Tasa-arvoaltuutetun toimisto

Adresa postare: PL 33, 00023 VALTIONEUVOSTO

Adresa: Mikonkatu 2 D, kati 6, 00100 Helsinki

Tel. (09) 160 4582

Posta elektronike: tasa-arvo@stm.vn.fi

www.tasa-arvo.fi

Drejtoria për të Huaj (Ulkomaalaisvirasto)

- merret me çështje që kanë të bëjnë me hyrjen në Finlandë, qëndrimin në vend dhe me refugjatët
- vendos për çështjet e nënshtetësisë finlandeze
- jep shërbime informative autoriteteve dhe organizatave ndërkombëtare
- mban regjistrin e të huajve

Shërbimet për klientë të Drejtorisë për të Huaj janë organizuar si më poshtë:

- Pritja e dokumentëve e hënë - e premte ora 8.00-16.15
- Informacione për kërkesa vetëm me shkrim ose telefon.
- Informata me telefon e martë – e enjte me numër (09) 476 5500
 - Çështjet e emigracionit ora 10 -11
 - Çështjet e refugjatëve dhe azilkërkuesve ora 14 -15
 - Çështjet e nënshtetësisë ora 14 -15

Informacione lidhur me hyrjen në fuqi të kërkesës dhe fazat e shqyrtimit e hënë – e premte ora 8.00 - 16.15, me numër 0300 44300, çmimi 0,08 euro/min + pagesa lokale.

Ulkomaalaisvirasto
Adresa postare: PL 92, 00531 Helsinki
Posta elektronike: ulkomaalaisvirasto@uvi.fi
www.uvi.fi

Përfaqësia e Minoriteteve (Vähemmistövaltuutetun toimisto)

Objektivi i Përfaqësisë së Minoriteteve është të parandalojë diskriminimin etnik, të përkrahë marrëdhënie të mira etnike, të mbrojë të drejtat e minoriteteve dhe të huajve si dhe të mbikqyrë zbatimin e parimit të mosdiskriminimit racial. Detyra e Përfaqësisë së Minoriteteve është

- të përgjellë e përmirësojë pozitën dhe të drejtat e pakicave etnike dhe të huajve
- të raportojë mbi realizimin e barazisë si dhe të ndërmarrë nisma për heqjen e diskriminimit
- të jap informata mbi legjislacionin që ka të bëjë me diskriminimin etnik si dhe pozitën e pakicave etnike dhe të huajve, si dhe praktika e zbatimit të këtij legjislacioni
- të zbatojë detyrat e Përfaqësisë së Minoriteteve që janë përcaktuar në ligjin për të huaj (378/1991).

Vähemmistövaltuutetun toimisto

PL 34

00023 VALTIONEUVOSTO

Tel. 09-160 06

Posta elektronike: vahemmistovaltuutetun.toimisto@mol.fi

www.mol.fi/vahemmistovaltuutettu